

# *Kandila Ramazani*

IBRAHIM SEKRANI



# Kandila Ramazani

*Ibrahim Sekrani*

Prishtinë, 2024 / 1445 h


Titulli:  
**Kandila Ramazani**

Titulli në arabisht:  
سج رمضانیه  
(*Suruxbun ramadanije*)

Autor:  
**Ibrahim Sekrani**

Përktheu nga gjuha arabe:  
**Ledion Pupuleku**

Ballina:  
**Fatlum Zeka**

Boton:  
 **@Ibrahim.Sekrani**

*Të gjitha të drejtat e botimit janë të rezervuara për faqen:  
[@Ibrahim.Sekrani](#).*

Prishtinë, 2024 / 1445 h

KANDILA RAMAZANI

---

IBRAHIM SEKRANI



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

*Me emrin e Allahut, të  
Ejithëmëshihshorit, Mëshirëplotit!*



## **A është leximi i Kuranit specifikë e vetëm ditëve të Ramazanit?**

Tek fal namazin e sabahut gjatë Ramazanit vëren disa besimtarë që marrin të lexojnë Librin e Allahut për aq kohë sa ia lehtëson Zoti; gjithashtu tek fal namazin e drekës do të vëresh grupe të tjerë që lexojnë Kuran. Edhe pas namazit të ikindisë xhamia kumbon aq sa gati-gati të lë pa frymë nga zërat e garuesve drejt përfundimit të Kuranit.

Por, sapo mbrëmja e Ramazanit merr të bjerë konstaton lehtësisht se Kuranët janë mbyllur dhe tingujt e tij janë shuar. Deri në atë masë sa të hamendësohet se vlera e leximit të Kurani është specifikë e vetëm ditëve të Ramazanit! Njoh shumë miq që leximin e Kuranit gjatë natës e kryejnë për të përmbushur grafikun e tyre ditor. Ndryshe thënë, leximi i Kuranit gjatë natës kompenson atë të ditës. Nuk e çojnë nëpër mend se leximi i Kuranit në mbrëmje ka vlerë të pakrahasueshme!

Atëherë, si mund ta shpjegojmë këtë fenomen? Me sa duket ekziston një keqkonceptim. Duke qenë se dëgjojmë mbi vlerën e leximit të Kuranit gjatë Ramazanit, muaj karakteristikë e të cilit është agjërimi, menjëherë bëjmë një lidhje mes vetë agjërimit dhe leximit të Kuranit.



Në këtë rast kemi të bëjmë padiskutim me një keqkonceptim ngase netët e Ramazanit janë më të vyera se ditët e tij. Janë pikërisht tekstet fetare ato që bëjnë një pozicionim kohor të leximit të Kuranit gjatë natës duke i dhënë një vlerë të veçantë. Më poshtë do të citoj disa prej tyre.

Allahu i Madhëruar e tregon në mënyrë precize kohën e zbritjes së Kuranit. Ai ka zbritur i plotë në qiellin e dynjasë dhe më pas pjesë-pjesë sipas konteksteve dhe ngjarjeve i është shpallur Profetit ﷺ, siç konfirmon transmetimi i njohur i Ibn Abasit ؓ. Zoti thotë në dy ajete të ndryshme duke iu referuar kohës së zbritjes së Kuranit: **“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit.”** (Kadr, 1)

**“Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar. Vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmërues.”** (Duhan, 3)

Nata e bekuar është pikërisht nata e kadrit, një nga netët e Ramazanit. Dikush mund të pyesë: Përse Allahu i Madhëruar përzgjodhi natën e Ramazanit si kontekst kohor të shpalljes së Kuranit dhe jo ditën? Zoti ka dije absolute mbi vlerën e netëve të Ramazanit dhe lidhjes që ekziston mes tyre dhe Kuranit. Zoti e di mjaft mirë që netët e Ramazanit përkojnë dhe përputhen përsosmërisht me Kuranin. Për këtë arsye Allahu i Madhëruar deshi që Kurani të zbriste natën e Ramazanit!

Një nga veprat më të vyera të Profetit ﷺ gjatë Ramazanit ishte leximi i Kuranit në prezencë të Xhibrilit ؑ. Por, cilën kohë përzgjodhi Zoti për këtë lexim të përbashkët mes tyre?

Koha e leximit dypalësh të Kuranit mes Profetit dhe Xhibrilit nuk ishte gjatë ditës së Ramazanit, por natës. Ibn Abasi ﷺ thotë në hadithin e përcjellë nga Buhariu: *“I Dërguari Allahut ﷺ ishte njeriu më bujar. Bujaria e tij theksohej gjatë Ramazanit kur takohej çdo natë me Xhibrilin për të lexuar Kuranin.”*<sup>1</sup>

Vëreni se koha e zgjedhur nga Zoti për leximin e Kuranit ishte nata e muajit të Ramazanit! Jo ditë të caktuara, përkundrazi, por çdo natë: *“...kur takohej çdo natë me Xhibrilin për të lexuar Kuranin.”*

Vëreni gjithashtu se kjo kohë nuk ishte e rastësishme dhe sporadike! Allahu i Madhëruar nuk e zgjedh një kokë të caktuar përveçse në përputhje me një urtësi në dijeni të së cilës është vetëm Ai.

Disa njerëz mund të shprehen: Koha e takimit është përcaktuar me dakordësinë e Profetit ﷺ dhe Xhibrilit ﷺ duke mos qenë kështu derivat i drejtpërdrejt i ndërhyrjes hyjnore.

Një konkludim i tillë është i pasaktë pasi Allahu i Madhëruar thotë duke iu referuar engjëjve: **“(Xhebraili tha): ‘Ne (engjëjt) zbresim vetëm me urdhrin e Zotit tënd. Atij i përket gjithçka që është para nesh, gjithçka që është pas nesh dhe gjithçka që është në mes. Dhe Zoti yt nuk harron kurrë.’”** (Merjem, 64). Ai vë në dukje se koha e zbritjes së engjëjve është përcaktim hyjnor. Ibn Abasi ﷺ transmeton se i Dërguari Allahut ﷺ pasi i tha Xhibrilit: *“A do të na vizitosh më shpesh?, u shpall ajeti: ‘(Xhebraili tha): Ne (engjëjt) zbresim vetëm me urdhrin e Zotit tënd. Atij i përket gjithçka që është*

---

<sup>1</sup> Hadithin e përcjell Buhariu me nr. 3220.

*para nesh, gjithçka që është pas nesh dhe gjithçka që është në mes. Dhe Zoti yt nuk barron kurrë.”<sup>1</sup>*

Pra, koha në të cilën Profeti ﷺ dhe Xhibrili ﷺ e bashkëlexonin Librin e Zotit ishte përcaktim hyjnor. Ky fakt e inkurajon njeriun të meditojë më tepër mbi këtë aspekt.

Përcaktimi i natës për leximin e Kuranit nga ana e Profetit dhe Xhibrilit ﷺ bart në vetvete tregues të shumtë, gjë që ka tërhequr vëmendjen e një pjese të konsiderueshme të dijetarëve. Imami dhe eruditi i madh i dijetarëve të hadithit, Ibn Rexhebi, thotë: “Në hadithin e Ibn Abasit është e qartë se leximi i përbashkët i Kuranit mes Profetit dhe Xhibrilit është zhvilluar gjatë natës. Kjo tregon se leximi i Kuranit gjatë natës së Ramazanit preferohet të jetë më i shpeshtë nisur nga fakti se qëndron i shkëputur nga preokupimet e përditshme, kthjellohen aspiratat dhe njësohet zemra e gjuha në rrugën drejt meditimit. Siç thotë dhe Zoti: **“Natyrisht, adhurimi natën vepron më fuqishëm dhe fjala është më shprehëse.”** (Muzemil, 6)”<sup>2</sup>

Thuajse të njëjtën qasje ka dhe Ibn Haxheri: “Hadithi dëfton se nata e Ramazanit është më e mirë se dita.... duket se Profeti ﷺ bënte një shpërndarje të Kuranit të shpallur duke e lexuar çdo natë. Arsyeja e kësaj shpërndarjeje ka të bëjë me varietetin e adhurimeve, namazin e natës, rëndësinë e prehjes fizike të trupit, qëndrimin pranë familjes etj.”<sup>3</sup> Është e evidente se Ibn Haxheri bën një përfshirje më integrale

---

<sup>1</sup> Hadithin e përcjell Buhariu me nr. 3218.

<sup>2</sup> “Letaif el-Mearif”, shtëpia botuese Ibn Kethir, fq. 315.

<sup>3</sup> “Fet’h el-Bari”, (9/45).

duke theksuar parasëgjithash se nata e Ramazanit është më e vyer se dita.

Ibn Bazi, Allahu e mëshiroftë!, në një artikull të botuar me titullin *“Konkludime të saktë mbi dispozitat e namazit të natës dhe teravive.”* merr të shqyrtojë ndër të tjera disa dobi të përfuara nga hadithi i Ibn Abasit ؓ: “Leximi dhe studimi i Kuranit gjatë natës është më i mirë se ai i ditës ngase kjo është natyra e këtij bashkëleximi (mes Profetit dhe Xhibrilit), zemra është më e qetë, prania e saj më e ndjeshme dhe rrjedhimisht mundësia për të përfutuar më e lartë.”<sup>1</sup>

Madje dijetarët shprehen se vetë namazi i teravive dhe Kurani i lexuar në to dëshmojnë vlerën e netëve të Ramazanit. Ibn Tejmije thotë: “Leximi i Kurani gjatë teravive është praktikë e preferueshme me unanimitetin e të gjithë dijetarëve. Madje, synimi më sublim i teravive është leximi i Kuranit në mënyrë që muslimanët të dëgjojnë Fjalën e Allahut.”<sup>2</sup>

Vëreni se dëgjimi i Kuranit manifeston një nga qëllimet kryesore të namazit të teravive. Dhe namazi i teravive falet vetëm gjatë natës. Ja tek doli në pah një relacion i ri mes Kuranit dhe netëve të Ramazanit!

Ndoshta dikush mund të pyesë: A ka një kohë të posaçme për leximin e Kuranit gjatë natës? Faktikisht kohët janë të shumta: paraprirja e namazit të akshamit dhe jacisë në xhami të ofron mundësinë e leximit të Kuranit; koha në të cilën pritët shtrimi i

---

<sup>1</sup> “El-Xhevabu es-sahihu min ahkami salati el-lejli ve et-teravihi”, fq. 13.

<sup>2</sup> “El-Fetava”, (23/122).

darkës, kohë kjo e çuar dëm në shumicën e rasteve duke iu dhënë serialeve të ndryshëm televizivë cenes të spiritualitetit të këtij muaji; koha e syfyrit qoftë përpara ose pas tij etj. Leximi i Kuranit gjatë syfyrit ka një natyrë tjetër dhe të fal qetësi e rehati të papërshkrueshme...

Lexuesi i nderuar duhet të kuptojë se qëllimi i këtij artikulli nuk është tërheqja nga leximi i Kuranit gjatë ditëve të Ramazanit, Allahu na ruajtë, por ndër të tjera është edhe orientimi drejt një kohe më të vyer: netëve të tij. Aspirata jonë duhet të jetë shtimi i leximit të Kuranit gjatë ditë-netëve të Ramazanit.

Allahu e di më së miri.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin tonë ﷺ, familjen dhe sahabët e nderuar!

*Ramazan 1433 h.*

## Dëmet e iluzioneve

Nga imazhet më të përsëritur të Ramazanit është ai i këmbësorit që ecën në rrugë ose shoferit që qëndron në makinën e tij në pritje të semaforit, rrobat i ka të mbërthyer mirë, vetullat e ngrysurat, i gatshëm për të reaguar menjëherë dhe me energji të rëna në rrugën drejt dialogut e shkëmbimit të mendimeve... Nëse ky imazh rezulton të jetë i përsëritur për ju atëherë me të drejtë mund të pyesni të habitur mbi arsyen. Cila është arsyeja? Përse disa agjërues zgjedhin të paraqiten me këtë imazh kaq të tmerrshëm në Ramazan?

A po përjeton realisht ky person një gjendje rraskapitjeje dhe stërmundimi që ia kanë rrëmbyer vitalitetin?

E vërteta qëndron në faktin se një pjesë e agjëruesve jetojnë nën influencën e një iluzioni të rëndë psikologjik që i bën të ndihen të paaftë të përballojnë komunikimin e natyrshëm me njerëzit me arsyen, sipas tyre, të stërmundimit fizik. Madje edhe mund të shfryjnë përsërbrendshmi lodhje e mërzi. Ecën i përkulur sikur të jetë duke tërhequr zvarrë zinxhirë të rëndë. Kur merr të ulet e lëshon trupin thua sikur e kanë lënë nyjat dhe gjymtyrët e trupit!

Po, agjëruesi përjeton shenja të lehta lodhjeje por i njëjti person i sipërpërshkruar mund të lodhet më shumë jashtë Ramazanit e megjithatë nuk të jepet si pjesë e një kortezhi xhenazeje!

Që do të thotë se një pjesë e konsiderueshme e imazheve në fjalë nuk janë produkt i mundimit të Ramazanit aq sa mund të jenë rezultat i iluzioneve dhe gjendjes së paqëndrueshme psikologjike.

Në rregull... Çfarë nuk shkon me këtë mimikë të mrrolur e ngrysur?

Ky person e ka privuar veten e tij nga një sërë portash me shpërblime e fitime të pallogaritshme nga ana e Allahut të Madhëruar. Qëndron i privuar nga gëzimi që të jep agjërimi, kënaqësia e adhurimit të Zotit duke hequr dorë nga të ndaluarat në shenjë nënshtrimi ndaj Tij, mbushja e zemrës me falënderim ndaj Zotit pasi ia ka bërë të mundur agjërimin etj.

Ndjenja e kënaqësisë me kryerjen e adhurimit është shenjë e përmbushjes dhe përplotësisë së tyre. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: **“O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kurani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët.”** **“Thuaj: ‘Me dhuntinë e Allahut dhe mëshirën e Tij - vetëm me këto le të gëzohen! Kjo është më e mirë se ajo që grumbullojnë.’”** (Junus, 57-58) Medito pak mbi vendimin e Zotit: **“... vetëm me këto le të gëzohen!”** Allahu do që ne të ndiejmë kënaqësi pranë Kuranit.



Ibn Kajimi thotë duke iu referuar mësuesit të tij Ibn Tejmijes mbi rrugët më të afërta që e lidhin zemrën dhe shpirtin e besimtarit me Allahun e Madhëruar: “E kam parë dijetarin e Islamit në ëndërr, Ibn Tejmijen, dhe pasi mora t’i lëvdoj e sublimoj një nga veprat e zemrës m’u drejtua me fjalët: ‘Udha që unë ndoqa ishte kënaqësia dhe lumturia me Zotin!’, ose diçka të përafërt me këtë. Kjo ishte gjendja

e tij në jetën e kësaj bote, kjo gjendje i shpërfaqej përsëjashmti dhe përsëbrendshmi.”<sup>1</sup>

Të jem i sinqertë, kur i lexova këto rreshta të Ibn Kajimit më ngërtheu fuqishëm një ndjenjë habie aq sa më mori fjalët. Nuk e di me kë të habitëm më parë; me gjendjen imanore të Ibn Tejmijes apo ëndrrën e Ibn Kajimit që udhëton drejt hollësirave të zemrës?!

Dallimi nuk është te jastëku apo krevati... por tek ato zemra që zgjedhin të flenë me brenga valëvitëse e ushtuese drejt hapësirave të imanit, drejt mbretërisë së imanit.

Kënaqësia me Zotin dhe kryerjen e adhurimeve! Indikacionet që na vijnë nga ajetet kuranore drejt këtij pohimi janë të shumtë. Ato vijnë nën termin e kënaqësisë, lumturisë, përgëzimit etj. Ibn Kajimi thotë: “Ndjenja e kënaqësisë ndaj Zotit, të Dërguarit të Tij, lumturia me besimin, sunetin, diturinë dhe Kuranin përfaqësojnë stadin më të lartë të njohësve të Zotit.”<sup>2</sup>

Mimika e agjëruesit tonë gjysma e poshtme e fytyrës së të cilit qëndron e varur ndërsa e sipërmja e mbuluar me vetullat e ngrysurat shpreh se e ka humbur lumturinë që të ofron robërimi ndaj Zotit. E ka privuar veten e tij nga një adhurim tjetër sublim; buzëqeshja dhe çelja e fytyrës, adhurim ky që konsiderohet sadaka. Ebu Dherri  transmeton se Profeti  e ka porositur: “*Mos nënvlerëso asnjë vepër të mirë madje edhe takimin e vëllait tënd fytyrëçelur!*”<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> “Medarixh es-Salikin”, (2/174).

<sup>2</sup> “Medarixh es-Salikin”, (3/150).

<sup>3</sup> Hadithin e përcjell Muslimi me nr. 2626.



Ebu Dherri ﷺ transmeton gjithashtu se i Dërguari Allahut ﷺ ka thënë: *“T’i buzëqeshësh vëllait tënd konsiderohet sadaka.”*<sup>1</sup>

Ndërsa Xheriri ﷺ thotë: *“Sa herë që më shihte, Profeti më buzëqeshte!”*<sup>2</sup>

Në momentin që agjëruesi e përvetëson këtë koncept sheriatik, pra që agjërimi është adhurim, menjëherë do të shijojë një kënaqësi të veçantë. Agjërimi nuk mund të shërbejë assesi si justifikim për të bllokuar portat e komunikimit me botën e jashtme. Besimtari duhet të ndryshojë tërësisht përballë këtij simboli fetar dhe shtyllë të Islamit.

Çfarë kemi trajtuar më sipër manifeston një përpjekje për të diskutuar dhe analizuar një aspekt të iluzioneve psikologjike dhe mënyrën sesi ato arrijnë të reduktojnë shpërblimet.

Le të shqyrtojmë së bashku një nuancë tjetër të iluzioneve psikologjike!

Një pjesë e konsiderueshme e besimtarëve mundohen të lexojnë sa më shumë Kuran gjatë Ramazanit. Janë seriozë dhe të vendosur për t’i shumëfishuar hatmet. Disa të tjerë i kanë shtuar aspiratat duke i mbivendosur kësaj dhe meditimin; të tjerë ndoshta edhe studimin e tefsirit. Por, emëruesi i përbashkët i këtyre aspiratave është se nuk dalin përtej individit. Sa i përket familjarëve, e vetmja pritshmëri që ka ndaj tyre është shumëllojshmëria e ushqimit... sa

---

<sup>1</sup> Hadithin e përcjell Tirmidhiu me nr. 1956.

<sup>2</sup> Hadithin e përcjell Buhariu me nr. 3035.

më shumë ngjyra në sofrën e iftarit. Në qoftë se një ushqim i caktuar i mungon sofrës menjëherë nga gjuha e tij lëshohen shprehje të pahijshme, qortime e vërejtje.

O Zot! Sa e çuditshme! Karakterizohet nga një ambicie e lartë për të lexuar Kuran, por, tërësisht i shkujdesur ndaj marrëdhënies së familjes me Kuranin. I mban nën presion mes pjatave e tenxhereve.

Përse e gjithë kjo? Sepse tipologjia e individit në fjalë pandeh se ligjërimi shariatik për leximin e Kuranit ka natyrë individuale/personale. I Dëgjon me ëndje vlerat e Kuranit dhe mendon vetëm për vetveten. Nëse do të ishte koshient se përkrahja që i ofron familjes duke i lënë kohë për leximin e Kuranit do ta shpërblente në të njëjtën formë siç shpërblehen edhe anëtarët e familjes, sjellja dhe qasja e tij do të ndryshonte tërësisht. Siç thotë Profeti ﷺ: *“Ai që fton drejt një veprë të mirë do të shpërblehet atë sa shpërblehen edhe praktikuesit e saj duke mos iu pakësuar (atyre) asgjë.”*<sup>1</sup>

Nisur mbi këtë parim, pra: *“Ai që fton drejt një veprë të mirë do të shpërblehet atë sa shpërblehen edhe praktikuesit e saj duke mos iu pakësuar (atyre) asgjë.”* dijetarët shprehen se veprat e mira nuk mund të bëhen me nijet që shpërblimi i tyre t'i shkojë Profetit ﷺ, pavarësisht se për çdo tjetër krahas tij është e lejueshme. Arsyeja është se shpërblimet e të gjitha veprave të këtij umeti i arkëtohen Profetit ﷺ pavarësisht nijetit paraprak. Është Profeti ﷺ ai që e ka ftuar dhe orientuar umetin e tij drejt çdo veprë të mirë! Ibn Tejmije

---

<sup>1</sup> Hadithin e përcjell Muslimi me nr. 2674.

ka një artikull të plotë ku e trajton këtë çështje dhe shprehet se dhurimi i shpërblimeve Profetit ﷺ është i ndaluar.

Besimtari duhet të jetë inteligjent dhe vigjilent në shfrytëzimin e rrugëve të shpërblimeve. Nëse ia lehtëson familjes barrën ushqimore të Ramazanit dhe i inkurajon për të recituar Kuranin do të shpërblehet më shumë sa mund të lexonte i vetëm.

Një nuancë tjetër e iluzioneve psikologjike që pakëson shpërblimet është praktika e një spektri të konsiderueshëm studentësh që lidhet me mexhliet e diturisë. Imam Ibn Rexhebi dhe selefë të tjerë hiqnin dorë nga mexhliet e diturisë gjatë Ramazanit pasi ishin të angazhuar me leximin e Kuranit. Ai përcjell se imam Zuhriu ka thënë: “*Ramazani është muaji i Kuranit dhe ushqimit të skamnorëve.*”; ndërsa imam Maliku i ndërpriste studimet e hadithit dhe i jepej tërësisht Kuranit.<sup>1</sup> Allahu e di më së miri, por mesa duket këto shprehje të selefëve nuk kanë qenë aq të njohura mes tyre. I pari që mori t’i publikojë është imam Ibn Rexhepi në librin e cituar më sipër.

Një detaj që duhet theksuar këtu është se një pjesë e madhe e studentëve të dijes kanë krijuar konceptin se Ramazani nuk mund të shfrytëzohet për njohuri të tjera krahas Kuranit. Deri këtu nuk ka ndonjë ngërç. Problemi qëndron në faktin se mospasja e vullnetit dhe ambicies për ta mbushur ditën me Kuran, pasi fatkeqësisht i jepet kohë një apo dy orë në total pas namazeve, mbet në dilemë.

---

<sup>1</sup> “Letaif el-Mearif”, i Ibn Rexhebit, fq. 318.

Duke qenë se në vetëdijen e tij Ramazani nuk mund të shfrytëzohet për njohuri të tjera merr gradualisht të shtrihet dhe sofistikojë mënyrat e shtrirjes në kolltukë e divane. Shkallëshkallshëm i mësyn rrjeteve sociale, lundrimin në internet dhe bisedave boshe që në rastin më të mirë konsiderohen të lejuara.

Pra, shihni sesi nuk arriti që nga adhurimi më sublim në Ramazan, leximi i Kuranit, të zbresë në përfitimin e njohurive por u zhvendos menjëherë drejt dëfrimit dhe gjërave boshe!

Ah, iluzionet psikologjike!

Hipoteza e sotshme e njohur si *“Ramazani nuk është muaj i diturisë”* është e pavlefshme parë nga ky aspekt. Dituria është pa diskutim një veprat më të dashura tek Allahu. Në rast se besimtari përfundon me grafikun ditor të Kuranit dhe nuk ka më mundësi të lexojë le të angazhohet në fushën e diturisë. A ka më mirë se pas përfundimit të grafikut ditor të Kuranit t’i përvishemi sahihut të Buhariut, të lexojmë biografinë e Profetit ﷺ, të meditojmë rreth saj, të reflektojmë mbi jetën e tij, asketizmin, këshillat dhe sublimitetin e nefsit të tij?! Ose të marrë të përsërisë njohuri të mësuara më herët për të mos i harruar, t’i mësojë familjes së tij dispozitat e agjërit, teravive, zekatit, zekatit të fitrit etj!

Një nuancë tjetër e këtyre iluzioneve është se disa besimtarë i përkushtohen meditimit të Kuranit gjatë namazit të teravive por me fillimin e vitrit, namaz në të cilin preferohet leximi i sures *el-Ala* dhe *el-Kafirun*, tërhiqet së medituari ngase e konsideron si pushim

rutinë. Ndoshta ky aspekt duhet parë më përgjithshëm dhe duhet lidhur me mosnjohjen e urtësisë mbi përsëritjen e këtyre sureve specifike. Sure të tilla mund të përmendim: *el-Fatiha*, *el-Ala*, *el-Kafirun*, *el-Ikhlâs*, *es-Sexhdeh*, *el-Insan* etj. Fakti që përsëritja e tyre legjitimohet në namaze të caktuara nënkupton se kanë një rëndësi të veçantë dhe për rrjedhojë nuk duhen anashkaluar pa i kushtuar vëmendjen e duhur.

Ku janë ata njerëz që i përjetojnë këto kuptime dhe zemrat i mbushin me meditimin e sures më madhështore që mund të lexohet gjatë teravive, *el-Fatiha*, gjëja më sublime që ka thënë Mbreti i mbretërve?!

Iluzion tjetër mund të përmendim se besimtarët, pavarësisht dëgjimit të këshillave të shumta mbi vlerën e leximit të Kuranit gjatë Ramazanit, nuk i shkon në mendje se leximi i tij mund të bëhet gjatë natës duke mos qenë agjërueshëm. Këtë e kemi trajtuar në artikullin e mëparshëm me temë: “A është leximi i Kuranit specifikë e vetëm ditëve të Ramazanit?”

Allahu e di më së miri.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin tonë alejhi salam, familjen dhe sahabët e nderuar!

*Ramazan 1434 h.*

## Paradokse

Reflekto mbi këto pesë skena përpara se të diskutojmë dhe analizojmë bashkërisht fenomenin e çuditshëm njerëzor:

1. Një pjesë e jona e hap Kuranin përpara duarve për të lexuar dhe menjëherë i vjen rëndë nga koha kinse e gjatë e kaluar përballë tij. Pa kaluar as çerek ore nis të numërojë faqet në fund të xhuzit, herë i hedh sytë drejt orës për të parë sa kohë ka kaluar dhe herë preokupohet me mendime sipas tij më të rëndësishëm. Këto janë justifikime për të ndërprerë leximin e Kuranit ose marrë një sy gjumë.

Sapo ta vendosë kokën në jastëk ndez telefonin dhe i mësyn rrjeteve sociale. Dergjet pas komenteve, gishti që lëviz sa lart e poshtë duke shfletuar faqet dhe papritur ka kaluar më shumë se një orë e plotë ose më tepër. Gojëhapur dhe i qetë sa askush nuk e ka ndierë. Shpeshherë detyrohet që t'ia imponojë vetvetes mbylljen e telefonit për të mos fjetur vonë.

Si ka mundësi që qëndrimi përpara Kuranit për gjysmë ore duket i pafund ndërsa në anën tjetër zhytja për orë të tëra në rrjetin social facebook, X (ish twitter), whatsapp, etj. duket e papërfillshme?!

2. Me të hyrë miku ynë Ramazani njerëzit nisin të interesohen mbi imamin që lexon Kuran më shpejt se të tjerët thua sikur jemi në garë maratone. Pavarësisht se arrin ta lokalizojë imam që lexon më shpejt dhe i bashkohet në namaz sërish shikimi i mbet ngulitur tek ora ndërsa mendja në përlllogaritjen e kohës së mbetur.

Një pjesë tjetër e jona pas faljes së disa netëve të namazit të teravive nis të shkëputet. Zgjedh t'i largohet xhamisë ndërkohë që pas tij besimtarët qëndrojnë në këmbë përballë Zotit të tyre. Ndoshta edhe të propagandon se qëndrimi në këmbë është i lodhshëm, këmbët të krijojnë dhimbje dhe imamllarët, Zoti i udhëzofte, e tejzgjasin namazin. Është po i njëjti person, jo një tjetër, që përshkon pa përtuar tregje të tërë gjatë Ramazanit duke mos ndierë as lodhjen më të vogël! Nuk ia ka nevojën uljes, relaksimit apo çkontraktimit të muskujve të këmbës...

Si është e mundur që të përfytyrohet qëndrimi prej çerek ore në këmbë si lodhje e mundim ndërkohë që vërtitja nëpër tregje e qendra tregtare dhe aktiviteti fizik në lojëra të ndryshme për orë të tëra të konceptohet si relaksues?!

3. Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve janë të përkushtuar dhe të dhënë pas shokëve në nivele të pabesueshme. Shpeshherë jam shtangur përballë historive të dëgjua! Djalosh që përshkon treqind kilometra brenda ditës pasi një mik, banues diku larg, i kërkoi diçka aspak të domosdoshme. Një tjetër nuk i merr në konsideratë distancat nëse shokët i komunikojnë përmes telefonit se janë mbledhur në

filan vend. Madje gjatë rrugës mund të përfytyrojë vetëm humorin dhe argëtimin që e pret.

Është i njëjti person i përkushtuar për të shpërfillur distancat e gjatë kilometrike për hatër të shoqërisë që duke qëndruar i shtrirë përton t'i ofrojë diçka nënës së tij ose t'ia sjellë nga dyqani pranë shtëpisë! Përton, refuzon dhe vetëm shfryn... Ndoshta edhe nis të ankohet duke i thënë nënës se duhet ta kishte njoftuar përpara mbërritjes në shtëpi.

Madje, ka të tillë që zgjedhin të frekuentojnë shokët duke refuzuar përcjelljen e nënës në spital për të kryer vizitat mjekësore. Nis t'i shfaqësohet nënës se një nga të afërmit do ta shoqërojë. Edhe nëse e shoqëron nënën e tij do ta bëjë hundëvarur!

Ende vazhdoj të pyes veten... si mund të shpërfillen kilometrat e gjatë në shërbim të miqve ndërkohë që përton të kënaqë nënën duke i blerë diçka në marketin e lagjes?!

4. Nis të bjerë alarmi i zgjimit për në punë dhe dora endet pakontrollueshëm në tavolinën ngjitur për t'u siguruar se ora e shënuar në telefon nuk e ka kaluar tetën. Por, e ka kaluar! Çohet vrullshëm dhe i tmerruar, merr abdes me nxitim, shtron sixhaden dhe nis të falë sabahun pasi ka hyrë koha e namazit të duhasë. Dielli ka lindur. Është fillimi i ditës. Nuk po falet i hidhëruar, i penduar dhe me zemër që shfaq pikëllim. Sapo i shpëtoi një nga shtyllat e Islamit! Madje gjatë namazit bënte nxitimthi llogaritë e rrugës që i duhej të përshkonte. Kur do të arrij në punë? A do të arrij ta shënoj



prezencën brenda limitit kohor? Me të mbaruar namazin mbledh shpejt e shpejt sixhaden dhe e flakëron në skutën e dhomës. Vishet dhe niset drejt punës. Sapo hyn brenda zemra gati sa nuk i del nga vendi. Si do të reagojë shefi? Cila do të jetë përgjigjja ime pavarësisht kritikave të tij? Ndërsa qëndrimi i Mbretit të mbretërve, Zotëruesit të qiejve e tokës mbi namazin e humbur, shtyllën e Islamit, i është venitur ngase ka krijuar familjaritet me daljen e sabahut nga koha. Me vdekjen e zemrës vdes edhe pikëllimi për mëkatin. Plaga nuk i dhemb të vdekurit. Më i rëndë se vetë mëkati është vdekja e zemrës dhe pandjeshmëria e saj ndaj thumbimit që predispozohet të shkaktojë mëkati.

Është qesharake sesi një person i tillë i çrregullt ndaj namazit të sabahut dhe disiplinor në raport me punën ta konceptojë veten e tij si individ i suksesshëm. Ndoshta edhe mund t'i ofrojë këshilla e rekomandime të tjerëve rreth disiplinës, rigorozitetit, respektimit të orarit, seriozitetit në punë etj. Ndërkohë që as nuk i lëviz as qerpiku për namazin e sabahut të dalë nga koha!

5. Një person e ka të lehtë të shpenzojë sasi të madhe parash për të ndërruar telefonin, darkuar me miqtë në një restorant luksoz ose për të ndërmarrë një udhëtim turistik. Në të njëjtën kohë, nëse i kërkohet të ndihmojë vëllezërit e tij në besim, portofoli nis t'i tkurret pakuptueshëm. Femrat shpenzojnë shuma të mëdha parash për veshje të shtrenjta, çanta të çmuara dhe bizhuteri të kushtueshme. Sapo dëgjon një nevojtar, dora i shkon menjëherë te të shkoqurat.

Vëllezërit tanë nëpër botë kanë nevojë qoftë edhe për një monedhë me të cilën mund të fashojnë plagën e gjakosur ose shuajnë urinë.. ndërkohë që ne me gjakftohtësinë më të madhe shpenzojmë për luks të shfrenuar!

Padiskutim që përgjegjësia humane e shteteve është shumëfish më e madhe se ajo e individëve.

Në rregull... pesë skenat e mësipërme përfunduan. Le të analizojmë tani pjesën kuptimore të tyre. Për të qenë i sinqertë, skena të tilla dhe analoge të tyre përpiqem t'i sjell gjithnjë ndërmend në përditshmërinë time. Më pas pyes i habitur: Si ka mundësi që njeriu ndien lirshmëri për punë të caktuara të dynjasë dhe rëndesë e barrë nëse e njëjta vepër do të bëhej për hatër të Allahut?!

Leximi është po i njëjti! Si ka mundësi që në raport me Kuranin vështrësohet dhe përballë shkrimeve të whatsapp-it kthehet në tërheqës?!

Qëndrimi në këmbë është po i njëjti! Si ka mundësi që në namazin e teravive është i padurueshëm ndërsa duke u endur në tregje, salla sportive, ambiente festive dhe palestra ëmbëlsohet?!

Përshkimi i distancave është po i njëjti! Si ka mundësi që disa të rinj përtojnë të përshkojnë distanca të shkurta në shërbim të nënës dhe në raport me shoqërinë shfaqen të papërtueshëm?!

Edhe zgjimi nga gjumi është i njëjti! Si ka mundësi që përtojmë kundrejt namazit të sabahut dhe zgjohemi të frikësuar e merakosur për shkak të punës?!

Gjithashtu dhe shpenzimi i pasurisë është i njëjtë! Si mundet që portofoli hapet vetvetiu për çështje luksi dhe tkurret kur bëhet fjalë për hatër të Zotit?!

Përse jemi energjikë e ambiciozë përballë dynjasë dhe të plogështuar e përtacë në raport me ahiretin?!

Këto paradokse të frikshëm duhet urgjentisht të na kthjellojnë, zgjojnë, purifikojnë shpirtrat dhe ndërpresin çdo justifikim të mundshëm pas të cilit mund të mbahemi lidhur!

Por, a përmenden paradokse të tillë në Kuran mes veprave që bëhen për hir të dynjasë dhe po të njëjtave që bëhen për Allah? A e përdor Kurani këtë mekanizëm për të motivuar zemrat?

Po! Allahu i Madhëruar hedh dritë mbi këto paradokse mes ambicies për hatër të dynjasë dhe plogështisë lidhur me ahiretin.

Medito mbi faktin sesi injorantët e periudhës së injorancës (*xhahilijetit*) krenoheshin me përmendjen e virtyteve fisnore dhe shfaqnin apati e plogështi kur bëhej fjalë për Zotin! Allahu i Madhëruar thotë: **“Pasi t’i kryeni ritet e haxhit, përmendeni Allahun ashtu siç i kujtoni etërit tuaj, madje edhe më tepër!”** (Bekare, 200)

Reflekto mbi qasjen e disa njerëzve që i ngrenë duart drejt Zotit duke iu lutur të përkushtuar për çështje të dynjasë dhe në të njëjtën kohë hezitojnë të luten për ahiretin! Zoti i Madhëruar thotë: **“Disa njerëz thonë: ‘Zoti ynë, jepna të mira në këtë botë!’ Por, për këta, s’ka asnjë të mirë në botën tjetër.”** (Bekare, 200)

Vëre si Allahu i Madhëruar i paralajmëron ata njerëz që i nënshtrohen vendimeve të Zotit kur janë në përputhje me interesat

e tyre dhe në të kundërt, kur nuk i konvenojnë, u kthejnë shpinën. Zoti thotë: **“Dhe, kur thirren tek Allahu (Libri i Tij) dhe i Dërguari i Tij, që ai të gjykojë midis tyre, një grup nga ata kthejnë kurrizin.”** **“Por, nëse e drejta është në anën e tyre, ata vijnë përulësisht.”** (Nur, 48-49)

Pasi refuzuan t’u bashkëngjiten ushtrisë së udhëhequr nga i Dërguari Allahu ﷺ drejt Tebukut, Zoti thekson se nëse do të kishin të bënin me interesa të dynjasë do t’u ishin përgjigjur: **“Po të ishte përfitimi afër dhe rruga jo aq e gjatë, ata do të vinin pas teje. Por iu duk rrugë e largët. Dhe ata do të betohen në Allahun: ‘Sikur të kishim mundur, me siguri do të dilnim bashkë me ju,’ dhe kështu ata e shkatërrojnë vetveten; Allahu e di se ata janë gënjeshtarë.”** (Teube, 42)

Vëre si e ka përdorur i Dërguari Allahu ﷺ logjikën e këtij ajeti në shërbim të ilustrimit të shembujve tek merr të krahasojë mes ambicies së disa njerëzve për t’iu vënë ushqimit dhe plogështisë në raport me shkuarjen në xhami: *“Betohem në Atë që ka në dorë shpirtin tim se sikur ta dinin se do të gjenin (në xhami) kockë të mbështjellë me mish apo mishin e gjendur mes dy thundrave të bëshme, do të prezantonin në faljen e jacisë!”*<sup>1</sup> Pra, tregohen të plogësht në prezantimin në xhami. Sikur t’u ofrohej një vakt ushqimor atje, atëherë me patjetër do t’i mësynin.

Këto paradokse që shfaqen në kryerjen e së njëjtës vepër me dy sfondet e saj: hatri i dynjasë dhe hatri i Zotit, përbëjnë një pjesë të

<sup>1</sup> Hadithin e përcjell Buhariu me nr. 644.

spektrit të asaj që njihet si *darb el-emthal / ilustrimi i shembujve* në Kuran. Zoti e përdor ilustrimin e shembujve dhe paraqitjen e rasteve ekuivalentë si metodë fillimi dhe argumentimi. Ai thotë: **“Këta shembuj Ne ua paraqesim njerëzve, por ata nuk i kupton kush, përveç dijetarëve.”** (Ankebut, 43)

**“Sikur këtë Kuran t’ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë (mal) të përulur dhe të copëtuar nga frika e Allahut. Shembuj të tillë Ne u japim njerëzve, që ata të meditojnë.”** (Hashr, 21)

**“Sigurisht, në këtë Kuran, Ne u kemi shpjeguar njerëzve çdo lloj shembulli, por njeriu kundërshton më tepër se çdo krijesë tjetër.”** (Kehf, 54)

**“Vërtet, Ne u kemi sjellë njerëzve shembuj në këtë Kuran për çdo gjë, për t’ua vënë veshin.”** (Zumer, 27)

Shembujt e ilustruar në Kuran, siç thonë *mufesirët / dijetarët* e ekzegjzës kuranore, janë raste ekuivalentë dhe analogë e jo zbatime apo implementime të veçantë që i nënshtrohen rregullave specifike. Pra, Allahu i Madhëruar e ilustron një shembull në mënyrë që njerëzit ta kuptojnë dhe vendosin në funksion të analogjisë. Ibn Tejmije thotë: “Shembujt e ilustruar në Kuran janë analogji racionale.”<sup>1</sup>

Në përfundim dua të ndaj me ju një përvojë personale pasi kam vënë re që përdorimi i kësaj metodologjie kuranore është frytdhënës në aspektin e orientimit, këshillimit dhe kritikimit të njerëzve. Sa herë që konstatojmë plogështi, apati e lodhje në raport me një vepër të lidhur me ahiretin ndërkohë që edhe pjesa jote racionale merr të të

---

<sup>1</sup> “Bejan et-Telbis”, (2/130).

justifikojë, vepra këto si: lexim Kurani, namaz, mirësjellje ndaj prindërve, kërkim diturie, shpenzim në rrugë të Zotit, lidhje farefisnore etj, vendos një analoge të tyre me interesa të kulluara dunjaje! Më pas reflekto si je energjik në raport me veprat e dunjasë dhe i rënduar në raport me ato të ahiretit!

Allahu e di më së miri.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin tonë ﷺ, familjen dhe sahabët e nderuar!

*Rexheb 1434 h.*



## Femra dhe shfrytëzimi i mundësisë së agjërimit

Falënderimet i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar, paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të përzgjedhurin e profetëve dhe të dërguarve, Profetin tonë Muhamedin ﷺ, familjen dhe sahabët e nderuar!

Në këtë seksion do të flasim mbi shfrytëzimin e mundësisë së agjërimit nga ana e femrës. Në suren *et-Tabrim* Allahu i Madhëruar përmend karakteristikat e femrave të përsosura kulminacioni i të cilave konsistoi në martesën me të Dërguarin e Allahut ﷺ. Zoti thotë: **“Në qoftë se ai ju ndan, Zoti i tij mund t’ju zëvendësojë me gra më të mira se ju: myslimane, besimtare, të bindura, të kthyerat tek Allahu me pendim, adhuruese (të Allahut), agjëruese, të martuara më parë ose të virgjëra.”** (Tahrim, 5)

Mazhoranca e dijetarëve shprehet se fjala *saihat* e përdorur në ajet ka kuptimin e agjërimit. Kjo është dhe përzgjedhja e imam Taberit dhe Ibn Kethirit. Ajo që e përforcon më tepër këtë nuancë kuptimore është se *saihat* vjen me dy kuptime: agjërimit dhe luftë. Duke qenë se femrat nuk janë të ngarkuara me përgjegjësi luftarake konfirmohet automatikisht kuptimi i agjërimit.








Agjëruesja është quajtur *saihe* për arsye se *sijaha* ka qenë ritual i aplikuar nga femrat në kohët e hershme. Ky ritual konsiston në endjen e femrës e vetme në shkretëtirë pa qenë e pajisur me ushqim të nevojshëm. Kjo gjendje ekstreme përkthehej nga ana e tyre si shkëputje radikale nga çdo gjë me përjashtim të Allahut të Madhëruar. Nuk ka asnjë dyshim se *sijaha* është bidat! Zoti e cilëson agjërimitin *sijaha* në aspektin e heqjes dorë nga ushqimi. Pra, thënë shkurt agjërimiti është e vetmja nuancë legjitime e *sijaha*.

Ja tek po mbërrin hëna e Ramazanit duke ledhatuar lehtë fytyrat tona dhe sinjalizuar hyrjen e këtij muaji madhështor. A do ta humbasë femra besimtare mundësinë e shfrytëzimit të këtij adhurimi që Allahu i Madhëruar e konsideron virtyt sublim të bashkëshorteve të Profetit ﷺ?

Një *sijaha* legjitime në ditë të limituara...

Një ditë prej ditësh po qëndroja pranë disa të afërmeve të mia dhe po bisedonim. Në bisedë e sipër ato morën të tregojnë mbi mënyrat që disa muslimane zgjidhnin për të përmbushur këtë adhurim. Sinqerisht, mënyra si ato e shfrytëzonin agjërimitin duke lexuar Kuran, bërë dhikër, dhënë sadaka, ushqyer skamnorët, ofruar iftar, mirësjellë me prindërit, mbajtur lidhjet farefisnore, ndërprerë relacionin me mediat konsumeriste etj, më bëri të lumturohem tej mase. Normalisht që ekzistojnë edhe dukuri të tjera që e lëndojnë dhe pikëllojnë besimtarin mbi faktin se mirësi të shumta po na shpëtojnë duarsh.

Në dy sahihët shënohet hadithi i transmetuar nga Enesi  ku Profeti  ia mohon besimin atij që nuk ndien në zemër dashuri e dhembshuri për vëllezërit dhe motrat e tij besimtare. Profeti  thotë: *“Askush prej jush nuk beson (plotësisht) derisa të dojë për vëllanë e tij atë që do për vetveten!”* Nuk ka asnjë dyshim se një nga aspektet e shumëdëshiruar për besimtarët është shfrytëzimi i plotë i jetës në adhurimin e Allahut të Madhëruar, fitimi i Xhenetit dhe shpëtimi nga zjarri i Xhehenemit! Zemra të pikon kur sheh një vëlla ose motër në besim që nuk arrin t’i shfrytëzojë në mënyrën e duhur mundësitë e ofruara nga Allahu i Madhëruar.

E dashur motër... Ky muaj është një mundësi e papërsëritshme e shlyerjes së gjynaheve të një viti të plotë. Ebu Hurejre  transmeton se i Dërguari Allahut  ka thënë: *“Ramazani në Ramazan i shlyen gjynahet e bëra midis tyre nëse shmangen të mëdhatë!”* Motër e dashur, a është e udhës që ky rast i ofruar nga Allahu i Madhëruar të neglizhohet duke u dhënë pas propagandave me natyrë konsumeriste e kapitaliste? Propaganda e reklama të ndryshme instrumentalizohen për të rrëmbyer përkushtimin e besimtarëve në Ramazan. Dekor enkas për Ramazan, tryezë specifike për Ramazan, shtrojë ramazani, dizajn ramazani, veshje tradicionale, ambalazhim ramazani...

Për Allah, a është ky spiritualiteti që meriton Ramazani apo ndoshta kemi të bëjmë me folklor popullor?!

A do të arrijë Ramazani të jetë spiritual për ne?

E dashur motër... Netët e Ramazanit janë tejet të rëndësishme. Mos lejo të iluzionohesh se vlera e tij është vetëm gjatë ditës! Aspak! Madje netët e Ramazanit janë më të vyera se ditët. Allahu i Madhëruar e shpalli Kuranin natën e Kadrit: **“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit.”** (Kadr, 1) dhe tha duke iu referuar asaj: **“Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar. Vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmërues.”** (Duhan, 3) Ishte pikërisht nata koha në të cilën Xhibrili dhe Profeti ﷺ bashkëlexonin Librin e Zotit. Ibn Rexhebi konkludon nga ky hadith se leximi i Kuranit gjatë natës është vepër e preferueshme.

Meqenëse kjo është vlera e netëve të Ramazanit, motër e nderuar, më thuaj, a është fisnike që të kalohen në vendet më të urryera të Zotit?! Ebu Hurejre ؓ përcjell në hadithin e transmetuar nga Muslimi se Profeti ﷺ ka thënë: *“Xhamitë janë vendet më të dashura për Zotin ndërsa tregjet më të urryerat.”* Për hatër të Zotit, më thuaj, si mund të kalohen netët më të mira në vendet më të urryera?! A është ky vend i përshtatshëm për kalimin e tyre?

Të jemi realistë, situata sot është më e komplikuar. Koha kalohet duke u vërtitur në dyqane online nën influencën e një konsumerizmi kompleks ndërkohë që në këtë muaj presupozohet të purifikojmë zemrat. Fatkeqësisht jemi duke u angazhuar me të kundërtën e asaj që do Zoti!

Motër e dashur... Allahu i Madhëruar ia ka dedikuar të gjitha adhurimet njerëzve me përjashtim të agjërimit, shpërblimin e të cilit

e ka shumëfishuar me shtatëqind herë ose edhe më tepër pa iu nënshtruar procesit përlloraritës. Ebu Hurejre transmeton hadithin e përcjellë në dy sahihët se Profeti ﷺ ka thënë: *“Çdo vepër e birit të Ademit shumëfishohet nga dhjetë në shtatëqind fish. Allahu i Madhëruar thotë: ‘Me përjashtim të agjërimit pasi më përket Mua dhe Unë shpërblej për të!’”* Adhurim unik!

Më thuaj, për hatër të Zotit, a mund të kalohet dita e agjërimit brenda në kuzhinë, jo duke u marrë me gatimin e iftarit, por me kreativitet të shpalosur në ëmbëlsira e gatime të ndryshme?! Ushqimi i mjaftueshëm i shërben qëllimit kryesor të agjërimit: arritjes së devotshmërisë. Ekstravaganca në llojllojshmërinë e ushqimeve përplaset drejtpërdrejt me thelbin e agjërimit.

Është i trishtë fakti se këtë mund e sakrificë të jashtëzakonshme në drejtim të gatimit gjatë Ramazanit, deri në atë masë sa rëndohen edhe psikologjikisht, nuk e paraprijnë me nijetin specifik të ofrimit të iftarit për agjëruesit. Madje një pjesë e konsiderueshme synon thjesht ekstravagancën ushqimore.

Sa e sa femra të nderuara ka që me dorën e majtë trazojnë gjellën e me të djathtën përgatisin petat me synim kryesor shkrepjen e fotografisë perfekte! Vorbull mburrjeje e krekosjeje. Sa keq për një kohë të çmuar që shpenzohet për një koment të përkohshëm nën foton e ëmbëlsirave! Sa keq për atë mund të jashtëzakonshëm që nuk u shoqërua asnjëherë me nijetin e duhur!

Motër e dashur... Sa e sa vëllezër e motra kanë ndërruar jetë pa i ardhur sërish mundësia e agjërimit! Ja tek të ka begatuar Allahu i Madhëruar me agjërimin e këtij muaji! Të pyes për hatër të Zotit: Nëse një person të respekton a nderon, si ia rikthen?! A na shkon për shtat që këtë mirësi e begati të ofruar nga Allahu i Madhëruar ta shpërdorojmë duke ndjekur stacionet televizive, vulgaritetin dhe dekadencën kulturore që ato përcjellin?! Si mundemi që në muajin e faljes, lirimit nga zjarri i Xhehenemit dhe shumëfishimit të shpërblimit t'i jepemi dëgjimit dhe shikimit të haramëve?!

Motër e nderuar... Sikur përgjegjësia të ishte individuale çdo gjë do të rridhte lehtëshëm. Por, a e di si Profeti yt ﷺ thotë në hadithin e transmetuar nga Ibn Umeri ؓ dhe përcjellë në dy sahihet: *“Të gjithë jeni barinj dhe çdo bari është përgjegjës për kopenë e tij; udhëheqësi shtetëror është bari dhe përgjegjës për kopenë e tij; bashkëshorti është bari dhe përgjegjës për familjen e tij; bashkëshortja është bareshë dhe përgjegjëse për shtëpinë e bashkëshortit të saj dhe fëmijët; skllavi është bari dhe përgjegjës për pasurinë e padronit të tij. Të gjithë jeni barinj dhe përgjegjës mbi kopetë tuaja!”* Motër e nderuar, ti përfaqëson një hallkë të rëndësishme të zinxhirit që ka formësuar vetë Ligjvënësi. A i shkon për shtat kësaj përgjegjësie të shohë fëmijët e saj të rehatuar në dhomën e kondicionuar ndërkohë që muezini thërret: *“Ejani në namaz, ejani në shpëtim?!”* Fëmijët e tu po privohen nga kjo thirrje! A je e lumtur që fëmijët e tu të jenë subjekt i ajetit: **“Pas atyre erdhën breza që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epshet e veta. Ata do të pësojnë dënimin e madh.”** (Merjem, 59)

Vallë, e ke harruar përgjegjësinë ndaj familjes tënde përballë Allahut të Madhëruar?!

Një nga shprehjet më të pakuptimta që kam dëgjuar është: “Unë përpiqem t’i zgjoj por nuk mundem më!” Betohem në Allah që kjo është vetëmashtrim! Për hatër të Zotit, nëse djali yt do të zgjidhte të flinte duke refuzuar frekuentimin e provimit, a do ta lejoje?! A do të thoshe: “Unë përpiqem por nuk mundem?!” A është dynjaja më e vyer për ne se shtylla e Islamit? Allahu i Madhëruar thotë: **“Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar.”** (Ala, 16-17)

Motër e nderuar... Fakti që je bareshë në shtëpinë tënde nënkupton që bart mbi supë përgjegjësi të mëdha. Duhet të zgjosh ndërgjegjen e familjes mbi madhështinë e këtij muaji, t’i përkushtohesh faljes së namazit dhe leximit të Kuranit nga ana e fëmijëve, t’i inkurajosh drejt ushqimit të skamnorëve, dhënies së sadakasë, heqjes dorë nga programet çedukuese televizive dhe kalimin e orëve të vona pa gjumë. Mos lejo e nderuar motër që të të shpëtojë ky shans! Tëto që në përfundim të këtij muaji të jesh pjesë e karakteristikave që përmend Allahu i Madhëruar: **“Në qoftë se ai ju ndan, Zoti i tij mund t’ju zëvendësojë me gra më të mira se ju: myslimane, besimtare, të bindura, të kthyer tek Allahu me pendim, adhuresë (të Allahut), agjëruese...”** (Tahrim, 5)

Allahu të dhëntë sukses e mbarësi! Allahu është padyshim më i Dituri dhe më i Urti! Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin tonë ﷺ, familjen dhe sahabët e nderuar!



*Cicërimi te përzgjedhura*





## Cicërima të përzgjedhura<sup>1</sup>

- Sa më shumë që robi e ka parasysh Ditën e Gjykimit dhe takimin me Allahun, aq më shumë edhe do të përfitojë nga Kurani. **“Ti kujto me këtë Kuran atë që i druhet kërcënimit Tim!”** (Kaf, 45); **“Paralajmëroji nëpërmjet tij (Kuranit) ata që i frikësohen llogarisë para Zotit të tyre...”** (En’am, 51)

- Nga skenat me të ndjeshme në Kuran dhe me shumë ndikim, është ajo e pendimit në Ahiret: **“Ditën kur fytyrat e tyre të përmbysen në Zjarr ata do të thonë: “Të mjerët ne! Ah sikur t’i ishim nënshtruar Allahut dhe t’i ishim bindur të Dërguarit!”** (Azab, 66)

Dhe ja pra, ne akoma kemi mundësi për të vepruar...

- Njeriu gjatë agjërimit seç e ka një qetësi dhe prehje shpirtërore, mbase nga të përmbajturit nga ushqimi e pija e tepërt... Ndaj më së shumti çfarë të ndihmon në meditimin e Kuranit dhe kuptimin e tij, është të përmbajturit prej të tepërtave.

- Sapo ta kesh përfunduar së lexuari pjesën e caktuar të Kuranit, tashmë kalo në një gjendje tjetër të besimit. Përjetoje mirësinë dhe

---

<sup>1</sup> Me cicërima kemi për qëllim thëniet e autorit të publikuara në rrjetin social twitter, tashmë të njohur sikur X. Kemi përzgjedhur kryesisht ato thënie që kanë të bëjnë me Kuranin, namazin dhe Ramazanin.

dhuntinë e Allahut ndaj teje që të ka nderuar të qëndrosh disa çaste me Librin e Tij.

- Hë, më thuaj ç'të shkon ndërmend kur zakonisht shkon në Xhami? Për Allahun, ndalu pak çaste dhe përjetoje këtë hadith ku Profeti ﷺ ka thënë: *“Atij që shkon e vjen prej xhamisë, Allahu i Lartësuar, sa herë që ai shkon e vjen, i përgatit vendbanime në Xhenet.”* (E shënon Buhariu)

- Përvoja ka treguar se kompromisi me veprat që kanë të bëjnë me besimin, si pjesa e caktuar e leximit të Kuranit, *dhikri*, shkuarja në xhami, vizita e prindërve, etj, në emër të kursimit të kohës, apo kryerjes së ndonjë pune urgjente... rezulton me ndëshkim, gjegjësisht me të kundërtën e asaj që është synuar.

- Pjesa e caktuar e leximit ditor të Kuranit (ar. *viridi*) - siç e kam dëgjuar një burrë të mirë duke thënë - në ditën e parë është e vështirë sa një kodër, në të dytën sa gjysma e saj... në të katërtën të bëhet sikur ushqimi që s'mund të rrish pa të.

- Forcimi i bindjes në zemër për Allahun është nga shkaqet më të mëdha të përqendrimit në sprova. Për këtë arsye Ibn Tejmije ka thënë: “Ata që arritën majat e bindjes, kur sprovohen nuk lëkunden, për dallim nga të tjerët...”

E, nëse pyet, a thua s'i kultivohet bindja në zemër? Ibn Tejmije ka thënë: “Bindja arrihet përmes tri gjërave: meditimit të Kuranit, soditjes së mrekullive të kozmosit dhe vetëve tona, si dhe të punuarit me diturinë.”

- Nga efektet e përmendjes së Allahut (*dhikrit*) që kanë mahnitur edhe ata që e kujtojnë shumë Allahun, është përqendrimi dhe prehja e zemrës së tyre, fokusimi dhe mos zhvendosja e saj. Kthjelltësia e mendjes përgjatë punës tënde varet nga hisja e *dhikrit* në hershmërinë e ditës tënde.

- Nga mënyrat me të bukura sesi Allahu i Lartësuar na nxitë ta duam Xhenetin është ftesa e Tij që na e bën: **“Allahu, me mëshirën e Vet, ju fton në Xhenet...”** (Bekare, 221). Allahu i Lartësuar! Është Allahu Ai që po na fton për Xhenet! O Zot i Lartësuar sa i Mëshirshëm që je!

- Allahu i Lartësuar thotë: **“Melekët do t’i vizitojnë ata, duke u hyrë nga çdo portë: “Selamun alejkum! (Shpëtimi qoftë mbi ju!) Me durimin tuaj gjetët shpëtimin. Sa e mirë është Shtëpia e tyre e përjetshme!”** (Rad, 23-24). Vëreni se ç’shpëhje të mirësearchjes zgjodhën engjëjt për banorët e Xhenetit: **“Me durimin tuaj...”!** Seç na bën të kuptojmë se ata banorë i zbatuan disa urdhra dhe u përmbajtën nga disa tjera që e kundërshtojnë rehatinë e qejfet!

- Medito pak se çfarë na ndan neve nga Xheneti apo nga Xhehenemi. Në pyetje është vetëm çasti i vdekjes, kaq! Lexoje këtë përshkrim mahnitës të Profetit ﷺ i cili ka thënë: *“Xheneti është më afër jush sesa lidhësja e nallaneve tuaja. Ashtu është edhe Zjarri.”* (E shënon Buhariu)

- **“Ndërsa ai që ka për qëllim Botën Tjetër, duke qenë besimtar dhe përpiqet për të ashtu si i takon asaj, përpjekjet e tij do të jenë të shpërblyeshme.”** (Isra, 19) Përvoja dëshmon, se kush do që në

zemrën e tij të rritet përmallimi për ahiretin, le të lexojë për përshkrimin e Xhenetit dhe begatave të tij.

- Shumë njerëz kur të vendosin për një adhurim të caktuar dhe e ndajnë mendjen, si faktor kyç për sukses e llogarisin planifikimin dhe organizimin. Porse gjitha këto janë mjete sekondare, teksa mjete kryesor i suksesit mbetet kërkimi i ndihmës nga Allahu. Ndaj, megjithëse kërkimi i ndihmës së Allahut është adhurim më vete, prapëseprapë Allahu e përmend veçmas pas adhurimit, kur thotë: **“Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm tek Ti ndihmë kërkojmë.”** (Fatiha, 4)

- Njeriu ka nevojë për adhurime shtesë para dhe pas adhurimeve të caktuara. Me fjalë të tjera, ka nevojë për adhurimin e kërkimit të ndihmës së Allahut para adhurimeve të caktuara dhe pastaj, pas tyre ka nevojë për adhurimin e falënderimit të Allahut.

- Kur trupi sëmuret ndjen neveri ndaj ushqimit të dobishëm. Njashtu është edhe zemra, kur ajo sëmuret i vijë tepër e vështirë nxënia e diturisë. Me lehtësi shfleton budallaqe e gjëra tjera koti, ndërsa librat mbase i ka mbi tavolinë, mirëpo sa herë që zgjat dorën ndaj tyre, thuajse ajo i paralizohet!

- Nuk mjafton vetëm ta lexosh Kuranin, por bëje që suret të mbërthejnë loçkën e zemrës tënde. Profeti ﷺ i kishte thënë njërit prej sahabëve – prej ensarëve -: *“Ç’të shtyn t’i përmbahesh leximit të kësaj sureje?”* – Unë, me të vërtetë e dua këtë sure. – ishte përgjigjur ai. Atëherë Profeti ﷺ i tha: *“Dashuria jote për të do të të fusë në Xhenet”*

Ky sahabi e kishte zakon që pas leximit të sures *el-Fatiha*, para se të lexonte suren vijuese gjersa iu printe sahabëve të tjerë si imam në namaz e lexonte suren *Ihlas* (e njohur edhe si “*Kul Huve Allahu*”).

- Pa shiko pak gjendjen e besimtarëve se si i gjallëronin netët me Kuran! Allahu i Lartësuar thotë: **“Disa nga ithtarët e Librit i qëndrojnë besnikë të vërtetës duke lexuar ajetet e Librit të Allahut (Kuranin) gjatë natës dhe bien në sexhde (duke u lutur).”** (Al Imran, 113)

- Allahu i Lartësuar thotë: **“Kujto kur Ne e ngritëm malin mbi ta, sikur të kishte qenë një re, aq sa ata menduan se do të binte mbi ta! Ne u thamë: “Zbatoheni atë që ju kemi dhënë me këmbëngulje dhe kujtoni çfarë ka në të (në Libër), që të bëheni të devotshëm!”** (Araf, 171)

E gjitha kjo, për t'i nxitur njerëzit të kapën fort pas fjalëve të Allahut! **“Merreni seriozisht atë që ju dhamë (Teuratin) dhe kujtoni kumtet e tij, që të jeni të devotshëm!”** (Bekare, 63)

- “Meditimi” është nga çelësat e hapjes së thesareve të “breqetit” nga Kurani. Kjo se, po të mos ishte i tillë, Allahu nuk do ta pasonte përshkrimin e tij si të bekuar me meditimin. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ky është një libër plot bekime. Ne ta zbritëm ty atë, që ata të meditojnë në argumentet e tij dhe që të marrin mësim njerëzit që kuptojnë.”** (Sad, 29)

- Ende vazhdojnë të pyesin njerëzit, a ta lexojë Kuranin me shpejtësi për të përfituar sa më shumë nga shpërblimi i leximit të shkronjave, apo ta lexojë ngadalë e ta meditojë atë? Lëri përgjigjet dhe mendimet e krijesave, ndalu dhe përsiat rreth qëllimit të

Krijuesit: **“Ne e shpallëm Kur'anin si dallues (të së vërtetës nga e kota), për t’ua lexuar njerëzve dalëngadalë, dhe ashtu e shpallëm atë, pjesë pas pjesë.”** (Isra, 106)

- A thua vallë, a do të kalojë e gjithë jeta jonë në dëfrime e argëtime, ndërsa ne ende nuk e kemi shijuar ëmbëlsinë e Librit të Allahut përgjatë (namazit të) natës?

- Çdokujt që është i shkujdesur ndaj namazit me xhemat për arsyen më të vogël, ngushëllime për humbjen e kësaj mirësie kaq të madhe, siç shënon Buhariu se Profeti ﷺ ka thënë: *“Sikur ta dinin çfarë përmban namazi i jacisë dhe ai i sabahut, do të venin për t’i falur, qoftë edhe zvarrë.”* Pra, qoftë edhe zvarrë!

- Allahu i Lartësuar është betuar në Kuranin fisnik për vërtetësinë e profecisë së Muhamedit ﷺ. **“Ja, Sin! Beto hem në Kur’anin plot urtësi. Se ti (o Muhammed) je prej të dërguarve.”** (Ja sin, 1-3)

Ndaj, nga frytet e meditimt të Kuranit është arritja e gradave më të larta të bindjes për vërtetësinë e profecisë së të Dërguarit të Allahut ﷺ.

- Koha s’ka ndryshuar, është po ajo e njëjta kohë, mirëpo nëse njeriu nuk çlirohet nga prangat e materializimit, i duket se akrepat e orës po ecin me vrap gjersa është duke u argëtuar, ndërsa i duket se zvarriten e s’ecin fare gjersa lexon Kuran.

- Kur ta kujtojmë dhe përmendim Allahun është e udhës t’i përjetojmë begatitë fetare në të cilat gjendemi. Allahu i Lartësuar thotë: **“Përmendeni Atë, i Cili ju ka udhëzuar, se ju më parë ishit**

**të humbur.”** (Bekare, 198); **“... kujtojeni Allahun ashtu si jua ka mësuar Ai ato që ju nuk i dinit!”** (Bekare, 239).

- Kur Allahut t'i përulemi në sexhde, dije se veçse kanë filluar sekondat e furnizimit tuaj. Ndaj, pajisu prej depove të Allahut me udhëzim, furnizim, sukses... Janë çastet e furnizimit pa kufi!

- Kur njeriu pas bërjes së një vepre të mirë kthehet të shikojë nga vetvetja, udhëtimi i tij drejt Allahut do të cungohet. Për dallim nga ai i cili drejtohet nga Allahu ta falënderojë që e ndihmoi në këtë adhurim, ai ngrihet lartë në gradat e adhurimit.

- Disa djelmosha thonë: në të vërtetë ende s'jemi mësuar dhe adaptuar me namazin e natës. O vëllai im, kërko ndihmën e Allahut dhe të fillojmë së bashku që nga sonte. Më beso se do të shijosh ëmbëlsinë të cilën Allahu ua jep atyre që i drejtohen Atij.

- Njerëzit, në përgjithësi dallojnë në mënyrën se si i ngjallin ambiciet e tyre për shfrytëzimin e sezoneve të mirësive. Mirëpo, Kurani fisnik ka nënvizuar më madhështoren e tyre, ka theksuar se kohërat fisnike janë të kufizuara në numër, kanë çaste të numëruara dhe janë të pakta.

- Pa meditoje pak këtë vështrim kuranor të kohës së kufizuar në dy shtyllat e fesë islame: në agjërimin e Ramazanit: **“Agjërimi është për një numër të caktuar ditësh.”** (Bekare, 184); dhe në haxhillëk: **“Përmendeni Allahun në ditë të caktuara (të haxhit).”** (Bekare, 203).

- Nga mençuria dhe urtësia e besimtarit që mediton librin e Zotit të tij është që t'i shfrytëzojë këto tërheqje të vërejtjes në zgjimin



e vetvetes, ambicieve dhe vullnetit të tij. Kurdo që plogështohet dhe ambiciet i bien, i kujton ditët se janë të caktuara (në numër), kalojnë shpejt.

- Mos gabo të mashtrohesh se do të vijë një ditë dhe programi yt do jetë i rregulluar në harmoni së bashku me kërkesat e jetës. Do të vazhdosh të jetosh në betejën mes detyrave tua dhe rrëmujës së jetës. Imam Ahmedi thoshte: “Janë ditë të pakta.”

- Ti në çdo çast je duke shpenzuar nga kapitali yt i kohës, kështu që, ose do të blesh me të dituri dhe vepra të mira që përfiton prej tyre, ose do të shpenzohet ai kapital në soditje dhe vëzhgim që do të pësosh humbje dëshpëruese.

- Kush i kërkon ndihmë Allahut dhe i drejtohet Atij, Ai i Lartësuar do t’ia hapë dyert e suksesit dhe përkrahjes për mirësi nëpërmjet shkaqeve më të thjeshta, aq sa nuk do t’i kishin rënë ndërmend.

- Të gjitha portat e mirësisë, qofshin nga ato të diturisë apo ato të adhurimeve, në të vërtetë arrihen prej derës së kërkimit të ndihmës së Allahut. Njeriut nuk i hapën dyert e ndonjë adhurimi vetëm falë përpjekjeve të tij vetjake, apo planifikimit të tij të hollësishtëm të veprimit. Në të vërtetë i gjithë sukcesi në adhurime vijë në saje të bereqetit të kthimit tek Allahu.

- Njeriu duhet t’i drejtohet Allahut me përgjërime që ta bëjë prej atyre që i përkushtohen Kuranit. Duhet lutur Allahun me këmbëngulje dhe përuarje që t’ia mundësojë kuptimin e tij, të vepruarit sipas tij dhe ta bëjë prej atyre për të cilët thotë: **“Ata të cilëve**

**ua dhamë Librin e lexojnë (dhe e ndjekin) atë (Kuranin), ashtu si duhet.”** (Bekare, 121)

- Kurani nuk është thjeshtë një libër i mbushur me informata apo recitime rituale. Në të vërtetë është një mesazh dhe porosi që përmban kryeçështjen e çdo gjëje tjetër.

- Sakaqherë të ngjajë që njeriu të vërejë veten e tij të shmanget nga meditimimi i Kuranit, apo nga disa kuptime të tij, e paskëtaj ta kujtojë ajetin: **“Nëse Allahu do të kishte parë tek ata ndonjë të mirë, do t’i kishte bërë, vërtet të dëgjonin.”** (Enfal, 23); medoemos, ngelet pa frymë nga frika (se mos bën pjesë në ajet)!

- Shumë herë dëgjojmë ajete dhe hadithe, por seç ngjan të vazhdojmë në shpërfilljen tonë të zakonshme, thuajse sikur të mos i kemi dëgjuar (apo lexuar) fare ato! Allahu i Lartësuar thotë: **“Që i dëgjon faktet e Allahut kur i lexohen, e pastaj vazhdon sërish të tregohet mendjemadh, sikur nuk i ka dëgjuar ato! Paralajmëroji ata për një ndëshkim të dhembshëm.”** (Xhathije, 8).

- Prej çelësave dhe mënyrave më të rëndësishme e më, të përfitimit nga Kuranit është meditimimi i të vërtetave të dijes që Kurani prezanton për Allahun. Çfarë përshkruhet në Kuran për shoqërinë e fisshme e të lartë është gjëja më madhështore që pastron dhe dëlirë shpirtrat.

- *Tesbihu* - madhërimi dhe lartësimi i Allahut - është i pëlqyeshëm në katër kohëra të ndryshme. Allahu i Lartësuar thotë: **“Por ti ji i durueshëm ndaj fjalëve të tyre dhe madhëroje Zotin tënd në agim dhe në muzg! Edhe në një pjesë të natës madhëroje Atë, ashtu si edhe pas namazeve!”** (Kaf, 39-40); Sa madhështore që është

dashuria e Allahut ﷻ për *tesbihun*! Madje edhe namazi i tëri është *tesbih*.

- Gjendja e përjetimit të *sexhdes* pason nga ajo e qëndrimit në këmbë. Kështu, kur robi e zgjatë qëndrimin në këmbë në namaz dhe përmes leximit të Kuranit i pastrohët zemra, zgjidhet nyja e tij dhe thuajse nuk ngopet nga përlulja në *sexhde* dhe përgjërimi i Zotit, aq sa i vijë rëndë të ngrihet prej saj.

- Sa më madhështor që është mesazhi, aq më shumë i rritet pozita bartësit të tij. Pa më thuaj, ç'ka më madhështor se mesazhi me të cilën ka folur Zoti i gjitha botëve?! Teksa atë e zbriti zotëria i gjithë engjëjve - Xhibrili - në zemrën e zotërisë së mbarë njerëzve - Muhamedit ﷺ -.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Nuk ka dyshim se ky (Kuran) është Shpallja e Zotit të botëve. Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë.”** (Shuara, 192-193).

Së këndejmi, kushdo që e bartë këtë mesazh kuranor dhe e përcjellë te njerëzit, është nderuar me pjesëmarrje në këtë varg. A nuk e ke dëgjuar fjalën e Profetit ﷺ: *“Më i miri prej jush është ai që e mëson Kurantin e pastaj ua mëson të tjerëve.”*

- Vallë, çfarë aludon më shumë për shquarjen e muajit të Ramazanit me lexim të Kuranit në të, sesa vetë përzgjedhja e Allahut ﷻ që i bëri mu këtij muaji të jetë çasti i parë i zbritjes së Librit të Tij madhështor nga qielli në Tokë.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Ramazani është muaji në të cilin ka zbritur Kurani...”** (Bekare, 185)

- Nëse Allahu i Lartësuar ia ndaloi Profetit të Tij që të mos e ndërpret leximin e Kuranit me Kuran, atëherë çfarë mendon për atë që e ndërpret leximin e tij për çështje të kësaj bote.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Mos nxito (o Muhamed!) për ta lexuar Kuranin para se të përfundojë shpallja e tij...”** (Taha, 114); Pra, mos u ngut që të përsërisësh Kuranin para se Xhibrili të mbarojë leximin e tij. Bëj durim derisa ai të mbarojë, pastaj lexoje ti! (*Tefsiri i Sadit*)

- Nëse jemi të shkujdesur e mospërfillës para Ramazanit dhe mjaftohemi duke mëtuar se do t'i përvjelim mëngët e do t'i përkushtohemi adhurimeve sapo të hyjë muaji i Ramazanit... Në fakt, do të befsohemi nga paaftësia për një gjë të tillë, meqë shpirti është sikurse trupi, forcohet me ushtrime dhe stërvitje.

- Stimulimi që pason nga vetë stërvitja është shumë më i fortë sesa ai që rrjedhë nga ndjenja për vlerën e çmuar të një periudhe kohore. Për këtë, është veçuar muaji i Shabanit me agjërim të shtuar (para Ramazanit). Madje, disa nga selefi këtë muaj e kanë quajtur muaji i lexuesve (të Kuranit) si përgatitje për Ramazanin.

- Për gjatë tërë Ramazanit, nëse i ke falur namazet farze, sunetet dhe atë të taravisë, i bie që tashmë e ke lexuar apo dëgjuar suren *Fatiha* mbi një mijë herë (1000). Pa më thuaj tash, sa herë e ke meditaruar ajetin: **“Udhëzона në rrugën e drejtë!”** (Fatiha, 6).

- Sa e habitshme që është atmosfera e Ramazanit! Ora një pas mesnate dhe muslimanët e falin namazin e natës në xhamitë e tyre, dhe gjithçka merret si diçka e rëndomtë. Teksa, jashtë muajit

Ramazan, një veprim të tillë robi e konsideron tejet të vështirë, gati të pamundur, kurse në fakt janë në pyetje barrierat shpirtërore.

- Hadithi i njohur për lutjen e natës së Kadrit: *“O Allah ti je Falës dhe e do faljen, ndaj më fal mua.”*; nuk përkufizohet vetëm në këto shprehje, mirëpo ai përfshin edhe kuptimet e tij, pra në këtë natë theksohet soji i lutjeve të kërkimit të faljes së Allahut.

- **“Ajo (nata e Kadrit) është më e vlefshme se një mijë muaj.”** Edhe veprat e mira të kryera gjatë saj janë më të vlefshme dhe më të mira se puna në një mijë muaj, në të cilat nuk do të ishte ajo natë.

Ky fakt habit edhe arsyen e më të mençurve dhe të urtëve, seç bujari dhe mirësi të madhe që i ka dhënë Allahu i Madhëruar këtij umeti. Ashtu që njeriu mund të marrë shpërblimin për një vepër që as për 80 vjet jetë të mbushur me adhurime e vepra të mira nuk do ta arrinte.” Ibn Sadi.

- Buhariu e shënon hadithin: *“Kërkojeni Natën e Kadrit në netët tek të dhjetëshes së fundit të Ramazanit.”*; pra, kjo përfshin netët tek. Po ashtu Buhariu shënon: *“Kërkojeni Natën e Kadrit në dhjetëshen e fundit të Ramazanit: në nëntë, shtatë ose pesë netët e fundit.”*; këtu bëhet fjalë edhe për netët çift dhe nuk veçohen vetëm ato tek.

- Po që se me të vërtetë qëllon që kjo të jetë nata e fundit e Ramazanit, kujtoni fjalën e eruditit, asketit Ibn Rexhebit që ka thënë: *“Thuhet se Allahu i Lartësuar ua falë (gjynahet) robërve të Tij kur e plotësojnë namazin e natës së fundit të Ramazanit.”*

- Nga ajo çfarë di është se Ibn Hubejra ka mendimin se nata e xhumasë është më e sigurt (të qëllojë nata e Kadrit). Po ashtu është

përcjellë nga Ebu Bekr ibn Abdurrahmani se ajo (nata e Kadrit) është në natën e 17 e natës së xhuma. Ai mbështetet në përputhjen e saj me natën e Betejës së Bedrit.

- Le të mos jetë preokupimi yt vetëm në kryerjen e faljes së taravive. Mirëpo, të jetë përqendrimi yt më i madhi në përthithjen e udhëzimeve sa më të shumta prej ajeteve.

Ibn Tejmije (*Allahu e mëshiroftë!*) ka thënë: “Nga objektivat më madhështore të namazit të taravive është që të lexohet në to Kurani me qëllim që muslimanët ta dëgjojnë fjalën e Allahut.”

- Nuk është në pyetje koha, krejt problemi qëndron në ngatërrimin dhe cytjet e shejtanit ndaj teje. Ta falësh namazin e taravive për gjysmë ore të duket shumë gjatë, ndërsa katër-pesë orë në argëtim me miqtë tu i kalon fare lehtë, madje befasohesh sa shpejt iku koha.

- Ti o vëllai im që po ballafaqohesh me vetën tënde në betejën me ekranin televiziv apo atë të telefonit, kujtoji ditët e Ramazanit që janë të numëruara siç nënvizohet në Kuran. Largoje shikimin tënd prej tyre e mos e njollos muajin tënd, janë vetëm disa net të pakta.

- Ti o vëllai im që ke filluar që në ditën e parë të lexosh xhuza (pjesë) të shumë nga Kurani, dhe kësisoj vazhdove edhe në ditën e dytë, e pastaj, sakaq u ndale, të iku dita pa lexuar fare! Kujtoje se Ramazani i ka ditët e numëruara, janë pak!

- Nga mençuria e besimtarit, ai që mediton librin e Zotit të tij, është që të merr mësim nga këshillat e Allahut në Kuran për ditët e pakta të Ramazanit, e kështu t'i gjallërojë ambiciet dhe vullnetin e

tij. Me ç'rast, sa herë që ndodh të plogështohet, t'ia kujtojë vetvetes se muaji i Kuranit i ka ditët numëruara.

- A po e vëren gjendjen tënde tashmë në këtë dhjetëshe?! Se si po falesh natën për dy orë apo më shumë dhe po të vërshon një dyndje e besimit përgjatë tërë natës?! E po, kështu ishin burrat e selefrit përgjatë tërë vitit.

- Ti o vëllai im që po përvidhesh nga xhamia, ndërsa prapa teje besimtarët po falin namazin e taravisë! Mos harro se Ramazani i ka ditët e numëruara. Lidhi këmbët tuaja e përqendro në *saf*, seç do të habitesh sa shpejt që vjen dita Bajramit.

- Nga pamjet e habitshme në këto dhjetë net të fundit është të hasësh në ndokënd që qëndron duke lexuar (Kuran) pas drekës e ikindisë, ndërsa kur të vijnë netët që vlera e tyre është shumë më e madhe, e humb kohën në dëfrime nëpër kafene.

- Po qe se nuk po përpiqesh me zell të madh përgjatë ditës së Ramazanit, falënderoje Allahun që vlera madhështore është në dhjetë netët e fundit e jo në ditët e tij. Ndaj, le të mos ndodh të plogështohesh nga përmendja e Allahut në këto net prej akshamit e deri në sabah.

- Netët tek nuk janë vetëm (21, 23, etj.); porse netët tek llogariten prej atyre çfarë kanë kaluar pra, 21, 23, 25, etj., dhe llogariten nga këndvështrimi i netëve që kanë mbetur, që i bie, 22, 24, etj., kjo e fundit është përzgjedhja e Ibn Tejmijes (*Allahu e mëshiroftë!*).

- Shtatë netët e fundi të Ramazanit janë quajtur me disa emra, siç shënohet në Sahihun e Muslimit: *shtatëshja e mbetur, shtatëshja e fundit...* le t'i shfrytëzojmë se në pyetje është vetëm një javë.

- Iku fillimi i Ramazanit, iku edhe gjysma e tij, madje edhe disa net të para të dhjetëshes së fundit dhe ka filluar shtatëshja e mbetur, e këto kanë vlerë të çmuar të veçantë. Shënohet në Sahihun e Muslimit, hadithi që e transmeton Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “*Kërkojeni në dhjetëshen e fundit, pra Natën e Kadrit. Nëse ndonjëri dobësohet apo nuk mundet, së paku mos të dorëzohet në shtatëshen e mbetur.*”

- Veprat e ashtuquajtura shumë të rëndësishme të cilat ta gëlltiten kohën në Ramazan, ndërsa ti po arsyetoheshe se vështirë është të shtyhen për kohën pas Ramazanit, ja tashmë erdhi fundi i tij, e ti, s'është që e ke bërë namin me ato punë. Merr mësim për Ramazanin e ardhshëm.

- Nuk di formë tjetër më të mirë të përfitimit nga leximi i Kuranit dhe mbushjes së zemrës me madhësi për të sesa marrja me mend se kush po flet! **“Ne të tregojmë ty (Muhamed) historinë më të bukur përmes shpalljes së këtij Kurani...”** (Jusuf, 3); **“Vërtet, Allahu ju këshillon mrekullueshëm dhe vërtet...”** (Nisa, 58)

- Kur të tjerëve t'u paraprish për në safin e parë, apo kur ta zgjatësh sexhden në namazin tënd, kujdesu për zemrën tënde, se mos i mban mend te shikimi i njerëzve përreth teje. Transmetohet në hadithin autentik që e shënojnë Buhariu dhe Muslimi se Profeti ﷺ ka thënë (se në Ditën e Gjykimit): “... *mbesin vetëm ata që në këtë*



*botë kanë bërë sexhde për syfaqësi e për famë (dëshirë për lëvdata). Edhe këta nisen për të bërë sexhde, por shpina u shndërrohet në një asht të vetëm (dhe nuk arrijnë të përkulen)."*

- Umu Seleme ؓ ka thënë: Një natë Profeti ﷺ, me t'u zgjuar nga gjumi, tha: "*Subhanallah (i Lartësuar qoftë Allahu)! Sa e sa sprova kanë zbritur sonte e sa thesare janë hapur! Zgjoni zonjat e shtëpive (gratë e tij)...*" (E shënon Buhariu). Profeti ﷺ dëftoi për namazin e natës si shpëtim nga sprovat. Sekretin e kësaj qëndron në atë se ky adhurim është nga adhurimet e fshehta.

- Nëse zemra jote vonohet të përgjigjet për namazin e sabahut, që të mos e braktisë ngrohtësinë e shtratit, kujtoje se Profeti ﷺ ka thënë: "*Nuk do të hyjë në Zjarr askush që falet para lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij.*" (e shënon Muslimi) Po ashtu: "*Ai që i fal dy të freskëtat (sabahun dhe ikindinë), do të hyjë në Xhenet.*" (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)

- Ndoshta të ndodh të qëndrosh zgjuar deri në kohë të syfyrit, apo të zgjohesh nga fundi i natës, apo ke vendosur ta falësh namazin e vitrit në fund të natës, pastaj ç'do të bësh? Allahu i Lartësuar thotë: "**... dhe ata që në kohën e agimit kërkojnë falje.**" (Al Imran, 17); "**ndërsa në agim, ata kërkonin falje.**" (Dharijat, 18).

- Minutat e syfyrit të fundit, mbase e natës së fundit të Ramazanit...

O Zot na bëj prej atyre që e kanë agjëruar tërë Ramazanin, i kanë gjallëruar netët e tij me namaz nate si dhe natën e Kadrit, duke besuar dhe llogaritur në shpërblimin e Allahut!

*Biografia e autostit*



## Biografia e autorit

Ibrahim Sekrani është i biri i Omer ibn Ibrahim Sekranit. Ai rrjedh nga një familje e njohur e fisit Temim. Ka lindur më, 04.04.1976. Studimet fillimisht i nisi në Fakultetin për Studimin e Karburanteve dhe Pasurive Nëntokësore, në Universitetin “Melik Fehd”. Pasi e përfundoi vitin e parë në këtë fakultet, e la për t’u transferuar në Fakultetin e Sheriatit në Universitetin Islamik “Imam Muhamed ibn Sud” në Riad, ku edhe i përfundoi studimet bachelor. Ndërsa nivelin akademik master e arriti në degën e Politikave Fetare në Institutin e Lartë Juridik, pjesë e Universitetit Islamik “Imam Muhamed ibn Sud” në Riad. Pas kësaj, e arrin edhe një master tjetër në Britani, në Drejtësinë Ekonomike, pjesë e Juridikut, në Universitetin “Essex” në qytetin Colchester.

Ibrahim Sekrani në viti 2007 e kishte paraqitjen e tij të parë publike, përmes një shkrese me titull: “*Pasojat e diskursit sekularist*”. Në këtë shkrim ai i bëri të qarta pikëpamjet e tij, si një njeri i cili pason Islamit e pastër burimor. Ky shkrim bëri bujë të madhe duke nxitur reagime të ashpra të atyre që përkrahin ideologjinë iluministe.

Në botën arabe njihet si një opinionist dhe analist i cili provokon një këndvështrim tjetër nga analiza shabllon për kulturën perëndimore. Gjithashtu, përmes librave dhe shkrimeve të tij, ai trajton thelbin e çështjeve përmes trajtimit të tyre nëpërmjet Kuranit.

Është autor i disa librave, por deri në momentin që po flasim, të përkthyer dhe botuar në shqip janë:

- “Shtegu drejt Kuranit”,
- “Prehje kuranore”,
- “Shtigje të diturisë dhe besimit”,
- “Aventurat”,
- “Pushteti i kulturës dominuese”,
- “Pasojat e diskursit sekularist” dhe
- “Interpretimi modernist i trashëgimisë”.

*Permbajtja*



## **Përmbajtja**

<b>A është leximi i Kuranit specifikë e vetëm ditëve të Ramazanit?.....</b>	<b>7</b>
<b>Dëmet e iluzioneve.....</b>	<b>13</b>
<b>Paradokse.....</b>	<b>21</b>
<b>Femra dhe shfrytëzimi i mundësisë së agjërimit .....</b>	<b>31</b>
<b>Cicërima të përzgjedhura.....</b>	<b>41</b>
<b>Biografia e autorit.....</b>	<b>59</b>
<b>Përmbajtja.....</b>	<b>63</b>





*Kandila  
Ramazani*

IBRAHIM SEKRANI